

Elastovill E-KV-4

Membranë hidroizoluese, e përbërë nga fibra poliestre, me shtresa bituminoze elastomeri

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Elastovill E-KV-4 është një membranë hidroizoluese, e përbërë nga 250 gr fije poliestre të patretshme, me shtresa bituminoze elastomeri nga të dyja anët. Ana e sipërme është e veshur me kokrriza të imta rëre dhe ana e poshtme me fletë të hollë lehtësisht të djegshme, për një ngjitje të shpejtë dhe të thjeshtë. Proçesi i prodhimit dhe kontrolli i cilësisë së tij, janë plotësisht në përputhje me standardin EN ISO 9001.

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

Elastovill E-KV-4 është testuar sipas udhëzimeve të EN 13707, EN 13969 tipi A dhe T si edhe EN 14967. Falë elasticitetit të saj në temperaturë të ulët, ajo ofron mundësi shumë të mira përpunimi dhe aplikimi, si edhe ofron fleksibilitet dhe aftësinë për tu kthyer në gjendjen e saj fillestare edhe në temperatura të ulta. Një strukturë e plotë dhe elastike tregon qëndrueshmëri të shkëlqyer në rast riparimesh mekanike.

APLIKIMI

Elastovill E-KV-4 përdoret si një nga shtresat hidroizoluese në sistemin hidroizolues disashtresor dhe për këtë arsye përdoret si në ndërtime të reja, ashtu edhe në riparimin e çatave të rrafshta e të pjerrta, në ndërtimet nëntokësore, mbitokësore dhe në objektet industriale. Kjo membrane hidroizoluese rekomandohet në mënyrë të veçantë sidomos kur pritet një zhvendosje e madhe termike e nëntokës (ndërtim i lehtë, ngarkesa termike, beton i paizoluar dhe i dobësuar, nyje, çarje të zgjeruara etj). Ngjitja bëhet kryesisht përmes flakës së nxehtë në një vend të caktuar ose në të gjithë sipërfaqen, sipas kërkesave.



VILLAS

BMI Bramac Sisteme për çati Sh.p.k
Rr. "Ismail Qemali", Pall. 12 katësh (i ri)
Kati III, Zyra 6
1001 Tirana, Albania
www.bmigroup.com

TË DHËNA TEKNIKE

Trashësia	4,0 mm
Forca e tërheqjes (për së gjati/tërthorazi)	≥ 1000 N/50 mm / ≥ 700 N/50 mm
Elasticiteti ndaj tërheqjes (për së gjati/tërthorazi)	≥ 30 % / ≥ 30 %
Fleksibiliteti në temperaturë të ulët	- 20 °C
Rezistenca ndaj ngarkesës statike	20 kg
Rezistenca ndaj grisjes (për së gjati/tërthorazi)	≥ 250 N
Rezistenca ndaj goditjeve	800 mm
Papërshkueshmëria nga uji	400 kPa
Rezistenca ndaj zjarrit nga jashtë	Klasi F
Reagimi ndaj zjarrit	Klasi E
Përmasat e rulonit, Gjatësia/Gjerësia	10,0 m / 1,0 m
Numri i produktit	100705
Testuar sipas standarteve të BE-së	

Vlerat e dhëna janë nominale dhe subjekt i variacioneve statistikore. I nënshtrohen ndryshimeve teknike. Është detyrim i përdoruesit për të vlerësuar përputhshmërinë e specifikimeve të produktit dhe të sigurohet që ka një version të vlefshëm të fletës së të dhënave teknike.

Elastovill E-KV-4

Botimi: Prill 2018

MAGAZINIMI

Elastovill E-KV-4 duhet të vendoset vertikalisht dhe të ruhet nga lagështia, rrezet UV dhe temperaturat e larta. Në kushte atmosferike të ftohta, produkti duhet të qëndrojë në magazinë të paktën 12 orë pa ngrirë dhe vetëm pak përpara aplikimit, të zhvendoset në kantierin e ndërtimit.

